



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS GLLOGOC

Numri i lëndës: 2024:305872

Datë: 15.11.2024

Numri i dokumentit: 06460646

P.nr.246/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA NË GLLOGOC, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal. gjyqtari i vetëm gjykues Shefqet Baleci, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Remzi Duli, në çështjen penale kundër të akuzuarit F.V nga ..., rruga "... ' nr..., Komuna e Drenasit, për vepër penale Shpërdorimi i pasurisë së huaj, të parashikuar nga neni 318 par.1. të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.5447/2024, datë.30.10.2024, në shqyrtimin fillestar gjyqësor publik, të mbajtur me datë 14.11.2024, në prani të Prokurorit të Shtetit Rukije Sheshivari, të dëmtuarit B.V dhe të akuzuarit, me datë.14.11.2024, mori dhe publikisht shpalli si dhe përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I AKUZUARI: F.V, i biri i ... dhe i ..., e gjinisë ..., i lindur me në ..., Komuna e Drenasit, ku edhe tani e ka vendbanimin rruga "... nr..., me numër personal të letërnjoftimit ..., Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i pamartuar, ka të kryer shkollën fillore, i papunë, i gjendjës së dobtë ekonomike, më parë i pagjykuar, nuk zhvillohet procedure tjetër penale ndaj tij.

ËSHTË FAJTOR

SEPSE: me datë 19.09.2024, rreth orës 10:00, në fshatin, Komuna e Drenasit, me dashje e me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete, kishte përvetësuar pasurinë e cila i është besuar atij duke i shkaktuar dëm material të dëmtuarit-babait të tij B.V, ashtu që i akuzuari duke e shfrytëzuar mos praninë e babait të tij-të dëmtuarit B.V në shtëpi të tij, kishte marrë armaturat e serës dhe i kishte vendos pranë rrugës, me qëllim për të i shitur, dhe me datë 13.09.2024 i njëjti ia kishte shitur shporetin e druve të firmës "Smedereva" për hekur, me ç'rast babait të tij-të dëmtuarit B.V, i kishte shkaktuar dëm në vlerë të pacaktuar,-

- me këtë ka kryer vepër penale Shpërdorimi i pasurisë së huaj, të parashikuar nga neni 318 par.1. të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).

Andaj gjykata në vështrim të neneve 4,7,17,21,38,46,47,48,49,69 dhe nenit 318 par.1. të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK) si dhe neneve 359,360,364 dhe 449 par.2.6. dhe par.3. të Kodit të Procedurës Penale (KPP), i shqipton:

DËNIM TË KUSHTËZUAR ME GJOBË DHE ME BURG

Ashtu që gjykata të akuzuarit **F.V** i shqipton dënimin me gjobë në shumë prej **500 (pesqind) €** si dhe dënimin me burg në kohëzgjatje prej **3 (tre) muaj** dhe në të njëjtën kohë urdhëron që dënimi me gjobë dhe dënimi me burg të mos ekzekutohen nëse i akuzuari F.V, në afat prej **1 (një) viti**, nuk kryen vepër tjetër penale.

Detyrohet i akuzuari, që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej **30 €**, këtë në afat prej 15 ditë, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e nën kanosjen e përmbarrimit me dhunë.

Detyrohet i akuzuari, që për Programin për Kompensimin e Viktimave të Krimit, të paguaj taksën në shumë prej **20 €**, këtë në afat prej 15 ditë, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e nën kanosjen e përmbarrimit me dhunë.

I dëmtuari B.V nga ..., rruga "...” nr...., Komuna e Drenasit, lidhur me kompenzimin e dëmit të shkaktuar më këtë vepër penale, nuk ka ushtruar kërkesë.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, me aktakuzën PP.II.nr.5447/2024, datë.30.10.2024, ka akuzuar të akuzuarin F.V për shkak të veprës penale Shpërdorimi i pasurisë së huaj, të parashikuar nga neni 318 par.1. të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).

Gjykata ka caktuar shqyrtimin fillestar me dt.14.11.2024, ku ka ftuar Prokurorin e Shtetit të Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm Rukije Sheshivari dhe të akuzuarin, ashtu siç e parasheh neni 240 par.1. të KPP-së.

Pala e dëmtuar, ishte e njoftuar për seancën e shqyrtimit fillestar, ashtu siç e parasheh neni 240 par.2. të KPP-së, dhe ishte e pranishme në këtë seancë.

I dëmtuari është njoftuar me të drejtat e përcaktuara në bazë të nenit 63 të KPP-së.

Në bazë të nenit 318 par.2. të KPP-së, gjyqtari e ka pyetur të dëmtuarin se a ka paraqitur kërkesën pasurore juridike. I dëmtuari ka deklaruar se jo. Gjyqtari e ka udhëzuar të dëmtuarin, se mund të paraqesë propozim për realizimin e kësaj kërkesë në procedurën penale. I dëmtuari ka deklaruar, se nuk do të paraqesë propozim për realizimin e kërkesës pasurore juridike.

Në bazë të nenit 240 par.7. nënpar.1. pika.1. dhe 2. të KPP-së, në fillim të shqyrtimit fillestar, gjyqtari e ka informuar të akuzuarin që ai mund të paraqesë propozimet e mëposhtme, deri në datën e caktuar, e cila nuk mund të jetë më vonë se trëdhjetë (30) ditë nga shqyrtimi fillestar dhe atë: 1.-çdo kundërshtim ndaj provave të cekura në aktakuzë në pajtim me nenin 243 të KPP-së dhe 2.- çdo kërkesë për hedhjen e aktakuzës në pajtim me nenin 244 par.1. të KPP-së. I akuzuari deklaroi se e ka kuptuar këtë të drejtë.

Në fillim të shqyrtimit fillestar, gjyqtari e ka udhëzuar të akuzuarin për të drejtat e tij, ashtu siç e parasheh neni 241 par.1. të KPP-së. I akuzuari ka deklaruar se i ka kuptuar udhëzimet.

Gjyqtari ka çmuar se e drejta e të akuzuarit në mbrojtës është respektuar dhe se prokurori i shtetit ka përmbushur detyrimet që kanë të bëjnë në zbulimin e provave nga neni 239 të këtij Kodi, ashtu siç e parasheh neni 241 par.2. të KPP-së.

Në bazë të nenit 241 par.3. të KPP-së, Prokurori i Shtetit ka lexuar aktakuzën, duke përjashtuar pjesët e aktakuzës të specifikuar në par.3. të nenit 237 të këtij Kodi. I akuzuari ka deklaruar se e ka kuptuar aktakuzën. Në bazë të nenit 241 par.4. të KPP-së, pasi që gjyqtari është bindur se i akuzuari e ka kuptuar aktakuzën, të akuzuarit ia ka ofruar mundësinë të e pranojë fajësinë ose të deklarohet i pafajshëm.

I akuzuari ka deklaruar se e pranon fajësinë në tërësi në të gjitha pikat e aktakuzës, pastaj gjyqtari në bazë të nenit 242 par.2. të KPP-së, ka përcaktuar se: -1.-i akuzuari kupton natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë; -2.-pranimi i fajësisë bëhet vullnetarisht nga i akuzuari dhe pranimi i fajit nuk është rezultat i përdorimit të forcës, kërcënimeve apo premtimeve; -3.-pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban dhe -4.-aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Në bazë të nenit 242 par.5. të KPP-së, gjatë marrjes në konsideratë të pranimit të fajësisë, gjyqtari i mori pikëpamjet e prokurorit të shtetit dhe të dëmtuarit.

Të njëjtit deklarojn se janë përmbushur kushtet nga neni 242 par.2. të KPP-së.

Në bazë të nenit 242 par.6. të KPP-së, pasi që gjyqtari u bind se janë vërtetuar çështjet nga par.2. të nenit 242 të KPP-së, mori aktvendim me të cilin miratoi pranimin e fajësisë nga i akuzuari lidhur me veprën penale Shpërdorimi i pasurisë së huaj, të parashikuar nga neni 318 par.1. të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK) dhe konstatoi deklaratimet e të akuzuarit nga neni 242 par.2. të KPP-së.

Pastaj, në bazë të nenit 365 par.3. të KPP-së, gjyqtari mori aktgjykim, me të cilin të akuzuarin e shpalli fajtor për veprën penale të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).

Gjykata menjëherë sipas detyrës zyrtare, sipas nenit 356 par.3. të KPP-së, mori aktvendim për caktimin e seancës për caktimin e dënimit pas shpalljes fajtor të akuzuarit F.V për veprën penale të lartëtheksuar, për të marrë informacione shtesë me rëndësi për caktimin e dënimit. Ku të pranishëm në seancën për caktimin e dënimit ishin: Prokurori i Shtetit Rukije Sheshivari, i dëmtuari B.V dhe i akuzuari F.V, ku palët e lartëcekuar, në bazë të nenit 356 par.7. të KPP-së, kanë mundur të i paraqesin gjykatës: -1. çështjet për ashpërsim të dënimit, përfshirë të dhënat nga e kaluara kriminale e të akuzuarit; -2. çështjet për zbutje të dënimit, përfshirë edhe ato relevante për zbutje të dënimit nën minimumin e paraparë me ligj; -3. deklaratën ose argumentet për një dënim të përshtatshëm, qoftë me gojë ose me shkrim dhe -4. çështje tjera që gjyqtari i vetëm gjykues ose trupi gjykues i konsideron të rëndësishme për caktimin e një dënimi të përshtatshëm.

Në bazë të nenit 356 par.8. të KPP-së, është përcaktuar se dispozitat e zbatueshme për radhën e paraqitjes së provave në shqyrtim gjyqësor zbatohen përshtatshëmrisht gjatë seancës për caktimin e dënimit.

Në këtë seancë për caktimin e dënimit, Prokurori i Shtetit Rukije Sheshivari, deklaroi: mbetëm pranë aktakuzës, pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit, është i mbështetur në prova materiale, prova këto nga të cilat është ngritur aktakuza. Andaj, vlerësoi se ky pranim i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare dhe pa asnjë presioni edhe mbështetur mu në këto prova dhe në pajtim me vullnetin e të akuzuarit. I propozoi gjykatës që me rastin e matjes së lartësisë së dënimit, pranimin e fajësisë të e marr si rrethanë lehtësuese. Pranimi i fajësisë te merret si rrethanë lehtësuese.

I dëmtuari B.V, deklaroi: nuk kërkoi kompensim të dëmit, si prind nuk jam qe të dënohet djali im, kërkoi nga ai, qe të largohet nga rruga e gabuar dhe të kthehet në rrugë të mbarë dhe të bëhet i vyeshtëm.

I akuzuari F.V, deklaroi e kam pranuar fajësinë, gjykatës i premtoi se në të ardhmen nuk do të përsërisë vepra të tilla apo të tjera penale, pendohem për veprën e kryer penale, kërkoi falje, e pranoi se kam gabuar, shprehi keqardhje, kërkoi nga gjykata që të më shqiptoi një dënim sa më të butë.

Duke i vlerësuar me ndërgjegje provat e nxjerrura në procedurë një nga një dhe në lidhje me provat e tjera, në bazë të nenit 7 par.1. dhe nenit 360 të KPP-së, gjykata ka vërtetuar gjendjen faktike, të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Gjendjen e këtyre faktike gjykata e ka vërtetuar nga pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit, si dhe nga provat dhe faktet që i përmban aktakuza.

Nisur nga këto fakte dhe prova të vërtetuara në procedurë, në veprimet e të akuzuarit përmbushen të gjitha elementet qenësore të veprës penale Shpërdorimi i pasurisë së huaj, të parashikuar nga neni 318 par.1. të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), të cilën e ka kryer me dashje direkte sipas nenit 21 par.2. të KPRK-së, sepse ka qenë i vetëdijshëm për veprën e vet dhe e ka dëshiruar kryerjen e saj.

I akuzuari e ka kryer veprën penale Shpërdorimi i pasurisë së huaj, të parashikuar nga neni 318 par.1. të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), kjo veprë penale është veprë e kundërligjshme e cila është e përcaktuar me ligj si veprë penale, tiparet e së cilës janë të përcaktuara me ligj dhe për të cilën me ligj është përcaktuar sanksioni penal.

Për këtë veprë penale i akuzuari është shpallur fajtor, sepse në përputhje me nenin 17 par.1. të KPRK-së, thuhet se “kryesi i veprës penale është penalisht përgjegjës nëse është mendërisht i aftë dhe veprën penale e ka kryer me dashje apo nga pakujdesia”. Në rastin konkret i akuzuari këtë veprë penale e ka kryer me dashje direkte sipas nenit 21 par.2. të KPRK-së, ku është paraparë sanksioni penal.

Gjatë përcaktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata për të akuzuarin, pati parasysh të gjitha rrethanat rënduese dhe lehtësuese në kuptim të nenit 69 të KPRK-së, andaj si rrethanë lehtësuese për të akuzuarin merr faktin se e ka pranuar fajësinë në tërësi, nuk ka të dhëna se më parë ka qenë i gjykuar, nuk ka të dhëna se ndaj tij zhvillohet procedurë tjetër penale, gjykatës i premtoi se në të ardhmen nuk do të përsërisë vepra të tilla apo të tjera penale, pendohet për veprën e kryer penale, kërkon falje, e pranoi se ka gabuar, shpreh keqardhje dhe i gjendjës se do të ekonomike, ndërsa rrethana rënduese gjeti se kemi shkallë të lartë të dashjes nga i akuzuari gjatë kryerjes së kësaj veprë penale. Andaj edhe pse për këtë veprë penale është i paraparë dënimi me gjobë dhe me burgim deri në një (1) vit, të njëjtit ia shqiptoi dënimet me kushtë, duke vlerësuar se tërheqja e vërejtjes me kërcënimin e dënimit me gjobë dhe me dënim me burgim është e nevojshme të ndalojë që kryesi të mos kryej veprë penale, duke u bazuar në nenin 47 të KPRK-së, e duke ia caktuar dënimin me gjobë në shumë prej 500 (pesqindë) €, si dhe dënimin me burg në kohëzgjatje prej 3 (tre) muaj, këtë duke u bazuar në nenin 48 par.4. dhe nenin 49 par.5. të KPRK-së, dhe në të njëjtën kohë urdhëroi që këto dënime me gjobë dhe me burg të mos ekzekutohen nëse i akuzuari në afat prej 1 (një) viti, nuk kryen veprë tjetër penale, me bindjen se dënimi me gjobë i kushtëzuar si dhe me burg i kushtëzuar është në përputhshmeri të plotë me shkallën e rrezikshmerisë shoqërore të veprës penale dhe përgjegjësin penale të të akuzuarit dhe se i njëjti dënim do të ndikoi që të parandaloi të akuzuarin nga kryerja e veprave penale në të ardhmën dhe të bëjë rehabilitimin e tij si dhe të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëjë kompenzimin e të dëmtuarit për dëmet e shkaktuara nga vepra penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, çka është edhe qëllimi i tij i paraparë me nenin 38 të KPRK-së.

Vendimin që i akuzuari të paguaj në emër të paushallit gjyqësorë shumë prej 30 €, gjykata e bazoi në nenin 449 par.2.6. dhe par.3. të KPP-së. duke pasur parasysh zgjatjen dhe ndërlikueshmerinë e procedurës dhe gjendjen financiare të të akuzuarit.

Vendimin që të detyrohet i akuzuari që për Programin për Kompensimin e Viktimave të Krimit të paguaj taksën në shumë prej 20 €, gjykata e bazoi në nenin 36 par.3. nënpar.3.1. të Ligjit nr. 08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit, ku është paraparë se gjyqtarët me rastin e shqiptimit të sanksioneve penale për veprat penale të përcaktuara në nën paragrafi 3.1. të këtij paragrafi caktojnë edhe taksat për kompensimin e viktimave si në vijim: për veprat penale që gjykohen nga Departamenti i Përgjithshëm i Gjykatës Themelore në shumë prej njëzet (20) €.

I dëmtuari B.V nga ..., rruga “...” nr., Komuna e Drenasit, lidhur me kompenzimin e dëmit të shkaktuar më këtë veprë penale, nuk ka ushtruar kërkesë.

Nga e lartëtheksuara është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA NË GLLOGOC
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI PENAL
P.nr.246/2024, datë:14.11.2024

Bashkëpunëtori profesional
Remzi Duli

G j y q t a r i
Shefqet Baleci

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, personat e autorizuar (të paraparë sipas nenit 381 par.1. të KPP-së), kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Prishtinë (e paraparë sipas nenit 374 par.1. nënpar.1.1. të KPP-së), në afat prej tredhjetë (30) ditëve (e paraparë sipas nenit 380 par.1. të KPP-së), duke llogaritur nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit. Ankesa dorëzohet përmes kësaj gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.

Ankesa e personit të autorizuar e paraqitur brenda afatit të caktuar si më lartë, e pezullon ekzekutimin e aktgjykimit (e paraparë në bazë të nenit 380 par.3. të KPP-së).